REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E DREJTËSISË**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT**
**ZYRA PËRMBARIMORE LUSHNJE**

Nr.264 Regj

Lushnje, më 23.02.2022

VENDIM -SHPALLJE

*(Lidhur me ekzekutimin e "Urdhërit të Ekzekutimit" të titullit ekzekutiv të debitorit)*

Në Lushnje, sot më datë 23.02.2022,

Unë Brikena Luto, me detyrë Përmbarues Gjyqësor pranë Zyrës së Përmbarimit Lushnje, pasi studiova aktet proçeduriale të çështjes përmbarimore nr.264, datë 15.02.2022 bazuar në urdhërin e ekzekutimit të lëshuar në datë 31.01.2022 nga Prokuroria pranë Gjykata së Shkallës së Parë Lushnje,

K O N S T A T O V A :

Se në datë 15.02.2022 është depozituar pranë Zyrës së Përmbarimit Lushnje kërkesa e kreditorit Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje së bashku me urdhërin e ekzekutimit datë 31.01.2022 lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykata e Shkallës së Parë Lushnje për vendimin nr. 202, datë 27.09.2019 të Gjykaës së Shkallës së Parë Lushnje me palë:

- Kreditor: Buxheti i Shtetit
- Debitor : Refit Fejzo Petova
- Me objekt:Shpenzime proçeduriale në shumën 448 lekë,

Nga ana e Zyrës së Përmbarimit Lushnje ka filluar proçedurat në bazë të nenit 515 e vijues të K.Pr. Civile si dhe ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbrimor Gjyqësor*", i ndryshuar, për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv të sipërcituar.

Nga verifikimi i kryer nga ana jonë në bashkëpunim me organet kompetente rezulton se debitori Refit Fejzo Petova nuk ka marr dijeni nëpërmjet shërbimit postar, si rezultat i kësaj bazuar në nenet 133/a, 133/b dhe 144/a si dhe neni 517 të Kodit të Proçedurës Civile duhet të bëhet njoftimi me shpallje publike e debitorit lidhur me detyrimin që ka ai ndaj palës kredirore buxhtetit të shtetit për shpenzimet proceduriale në vlerën 448 lekë.

Sa më sipër në mbështetje të nenit 133/a, 133/b, dhe 144/a si dhe 517 të Kodit të Proçedurës Civile dhe ligjit nr.8730, daë 18.01.2001 " *Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbrimor Gjyqësor*", i ndryshuar.

VENDOSA:

1. Të kryej njoftimin nëpërmjet shpalljes publike me afat 20 (njëzet) ditor (duke marr parasysh edhe komunimin postar), nga data 24.02.2022 – 15.03.2022 të debitorit Refit Fejzo Petova;
2. Ky vendim përpilohet në disa kopje, ku një kopje afishohet në këndin e njoftimit të Zyrës së Përmbarimit Lushnje, një kopje dërgohet për afishim pranë në këndin e publikimeve të Bashkisë Divjakë, një kopje dërgohet për afishim në ambjentet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe një kopje dërgohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit Tiranë.
3. Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore Refit Fejzo Petova me banim në fshatin Mizë, Bashkia Divjakë;
4. Pala debitore Refit Fejzo Petova me banim në fshatin Mizë, Bashkia Divjakë të paraqitet pranë Zyrës së Përmbarimit Lushnje në lagjen " Çlirim", kati i parë, hyrja mbarapa në ambjentet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe të marr kontatkte me përmbaruesin gjyqësor të çështjes përmbarimore për t'iu vënë në dispozicion aktet e dosjes përmbarimore, pasi me kalimin e këtij afati do të vijohet me ekzekutim detyruar sipas nenit 519 e ne vijim të Kodit të Proçedurës Civile.

*U shpall në Lushnje, sot më datë 23.02.2022*

PËRMBARUES GJYQËSOR

Burkena Luto